



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

Sesioni pranveror  
Komisioni për Integritim Evropian  
Mbledhja nr. 43  
Prishtinë, më 16.04.2019, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti dhe Milaim Zeka.

**Munguan:** Donika Kadaj-Bujupi dhe Adem Hoxha.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

**Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.**

**Kryetarja**, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë:

**Rend dite**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 04.03.2019, 06.03.2019, 20.03.2019 dhe 28.03.2019;
3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2019-2023, e ftuar ministrja Dhurata Hoxha;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-101 për të drejtën ndërkombëtare private, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

### **Miratimi i rendit të ditës.**

Rendi i ditës u miratua.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 04.03.2019, 06.03.2019, 20.03.2019 dhe 28.03.2019;**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2019-2023, e ftuar ministrja Dhurata Hoxha;**

**Kryetarja** – Kemi për shqyrtim Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2019- 2023, duke qenë se Ministria e Integritimit Evropian është institucion koordinues i këtij procesi, ne ju kemi ftuar që të na prezantoni këtë dokument. Siç e dimë, tashmë ky është programi i katërt me radhë për zbatimin e MSA-së, në të cilin janë paraparë masa dhe aktivitete nga institucionet e Republikës së Kosovës, me qëllim të përmbushjes së reformave drejt procesit të integritimit evropian.

**Ministrja e Integritimeve Evropiane, znj. Dhurata Hoxha** – Qeveria e Kosovës, pas një procesi gjithëpërfshirës konsultativ, më 19 mars 2019, ka miratuar PKZMSA-në 2019 -2023.

Sa i përket strukturës së programit, ajo vazhdon të jetë e njëjta, pasi që është bazuar në kriteret e Kopenhagës dhe të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në 3 blloqe, me qëllim të rritjes së cilësisë. Vlen të theksohet se dallimi nga programi i mëparshëm vërehet si në sasi edhe në cilësi të tij. Numri i masave afatshkurta është zvogëluar për 25%, në krahasim me vitin e kaluar dhe janë definuar masat që priten të sjellin reforma konkrete dhe janë evituar masat që përbëjnë në aktivitete rutinë.

PKZMSA, që ka mbuluar vitin 2018-2022, ka përmbajtur gjithsej 534 masa, nga të cilat 147 kanë qenë legjislative dhe 387 masa zbatuese, ndërsa PKZMSA që po e diskutojmë sot, mbulon vitin 2019-2023, i cili përmban rreth 400 masa, nga të cilat 160 janë masa legjislative dhe 240 janë masa zbatuese.

Zvogëlimi i masave është arritur si rezultat i planifikimit më të mirë dhe është harmonizuar me planin vjetor të Qeverisë, në veçanti në masat legjislative, gjë që e bën më të realizueshëm programin.

Gjatë rishikimit të PKZMSA-së, vëmendje e veçantë i është kushtuar 3 aspekteve: bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet e qendrës dhe Qeverisë, planifikimit të qëndrueshëm dhe realist, përfshirë përmes harmonizimit me planin vjetor të punës së Qeverisë 2019 dhe dokumente të tjera për planifikim të politikave, përfshirë ato sektoriale, si dhe postimet. Për shkak të obligimeve që kemi marrë përsipër nga programi i BE-së për mbështetje direkte buxhetore për reformën në administratën publike dhe menaxhimin e financave publike për periudhën 2018-2020, janë paraparë caqet specifike të zbatimit të PKZMSA-së, dhe deri në fund të këtij viti, duhet të zbatohen së paku 280 masa afatshkurtra. Objektivi parësor i programit është përcaktimi i masave dhe prioriteteve që mundësojnë përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA, përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, si dhe avancimin e politikave, reformave institucionale dhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin në praktikë.

Kostoja totale e zbatimit të PKZMSA-së, që mbulon vitin 2019-2023, për këtë vit, është vlerësuar të jetë rreth 94.4 milionë € nga të cilat 81.8 milionë € janë nga buxheti i shtetit dhe 12.6 milionë € nga mbështetja e donatorëve.

Vlen të theksohet se PKZMSA 2019-2023, nuk ka vakum buxhetor. Sfidë kryesore konsiderohet ngritja e kapaciteteve institucionale lidhur me njohuritë e Acquis të BE-së

dhe funksionimi i strukturave koordinuese me integrim evropian, ngadalësia në miratimin e ligjeve në Kuvend. Ndërkohë, që Kuvendi është një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti, miratimin e legjislacionit, pra edhe kjo nuk ka ndryshuar në krahasim me programet e kaluara. Rol kyç do të ketë edhe Komisioni për Integritet Evropian. Kuvendi do të ndikojë edhe në strukturat e stabilizim-asociimit, në kuadër të Komisionit të Stabilizim-Asociimit. Sa i përket përbajtjes, programi i rishikuar paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave konkrete afatshkurtra dhe objektive prioritare afatmesme për zbatimin e MSA-së përmes përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së. Raporti i parë 3 muajor për zbatimin e PKZMSA-së 2019-2023, parashihet të publikohet në fillim të muajit maj 2019 dhe gjithashtu monitorimi i zbatimit të PKZMSA-së bëhet përmes platformës “online”. Institucionet përgjegjëse veç kanë dhënë kontributin e parë. Në kuadër të këtij cikli të monitorimit, Ministria e Integritet Evropian është duke bërë grumbullimin, vlerësimin dhe finalizimin e këtij raporti dhe posa të jetë gati, do ta ndajmë me juve të gjithëve.

**Kryetarja**– Ne, si Komision për Integritet Evropian, do të vazhdojmë të bëjmë mbikëqyrjen e përbushjes së PKZMSA-së dhe me ministritë e linjës, që i kemi në raportim vazhdimisht, por do të angazhohemi edhe në miratimin e legjislacionit, i cili është paraparë në PKZMSA. Ne bashkëpunojmë edhe me komisionet tjera të linjës dhe do të angazhohemi që të përbushim këtë program. Por, kërkoj nga Qeveria që projektligjet që parashihen në PKZMSA-në, mos të sillen me vonesë në Kuvend, sepse ne kemi pasur rast, që për shkak të këtyre vonesave, kemi marrë vërejtje pa të drejtë në miratimin e masave ligjore.

**Armend Zemaj**– Pasi që PKZMSA 2019-2023 është program i ri dhe sigurisht kualifikimi i tij në atë që ju, ministre e interpretuat, jo vetëm në aspektin politik dhe profesional, kërkon një angazhim dhe përkushtim shumëdimensional, në bazë të kompetencave që kanë institucionet përkatëse në zbatimin e saj.

Nuk do të theksoja që është ambicioz, sidomos te pjesa e masave legjislative dhe zbatuese, në krahasim me të kaluarën, jemi dëshmitar që jo të gjitha kanë qenë të implementuara, diku rreth 60%, andaj si ju e keni adaptuar mospërbushjen e 40% në programin e ri. Kur përmendet reformat konkrete, atëherë na tregoni çka mendoni me reforma konkrete për vitin 2019? Sepse, shihet edhe në praktikë se pjesa e sundimit të rendit dhe ligjit, ende vazhdon të jetë njollë e zezë. Mendoj që te masa zbatuese, ju duhet ta keni një kërkesë apo një përkushtim përtej kësaj, në raport me kolegët e juaj, që janë në dikasteret udhëheqëse të Qeverisë dhe kjo është, në vazhdimësi, edhe kërkesë e jona, jo vetëm si pjesë e këtij drafti që është për miratim dhe sigurisht LDK do ta shqyrtojë në baza sektoriale, që ta japë mendimin e vet në seancë plenare.

Sa janë të imponuara në këtë program kërkesat që kanë dalë nga raporti i Këshillit të Evropës për Kosovën, sepse janë disa që nuk ndërlidhen vetëm me MSA-në dhe kjo do të ishte në interes tonin.

Sa janë harmonizuar planet strategjike dhe sektoriale me institucionet tjera. Këtu e pashë te infrastruktura, se nuk është paraparë projekti i autostradës për Dukagjinin, pse nuk është paraparë?

Pjesa tjetër që ndërlidhet me reformën e plotë në administratën publike, ju i potencuat fondet që ne i presim nga BE, por edhe pjesa e obligimeve që ndërlidhet me masat legjislative dhe pjesa që mbetet e masave zbatuese, pa anashkaluar faktin edhe të zhvillimi ekonomik. Besoj që tani duhet të kalojmë në një nivel tjetër. Ne kemi Komisionin për MSA-në, nuk e di që e kemi mbajtur ndonjë takim me ju, gjatë vitit të

kaluar, sepse edhe unë jam anëtar i këtij komisioni dhe do të ishte mirë që të ndodhte me kërkesën e juaj, kësaj radhe.

Në fund, lidhur me përkthimin e Acquis komunitare, me legjislacionin në Kosovë, a keni ndonjë sektor të veçantë dhe a keni angazhuar ekspertë adekuatë, së bashku me Zyrën e BE-së në Kosovë? Pra, çfarë shtylle të komunikimit të këtij sistemi po përdorni, si ministri, që të na lehtësoni edhe neve, në mënyrë që mos të kemi duplikime të raporteve?

**Ministrja**, lidhur me pyetjen se çka kemi bërë me 40% të masave, tha se janë më pak, mirëpo masat që nuk kanë arritur të zbatohen, mbeten prapë prioritete të Qeverisë, për t'u zbatuar në vitet e ardhshme.

Sa i përket reformave konkrete, ky program në disa aspekte, është më kualitativ, sepse është fokusuar në plane konkrete e jo vetëm në plane që ministritë i kanë pasur. Jemi munduar të kemi veprime konkrete që e avancojnë zbatimin e MSA-së dhe këto janë edhe veprime konkrete në reformën e administratës publike, përkundër faktit që ne e kemi kaluar pakon e ligjeve të reformës së administratës publike, kjo nuk ndalet aty, tani kemi masa konkrete që do të monitorojnë zbatimin e ligjeve, pastaj edhe racionalizimi i agjencive të cilat janë një sërë masash dhe është një reformë e madhe dhe ky racionalizim është me afate kohore. U përmenden edhe reformat në arsim, Ligji për arsimin e lartë ende nuk ka kaluar dhe ky ligj është njëri prej shtyllave kryesore të reformave, duhet bërë ndërlidhjen në mes të kurrikulave të shkollave me nevojat e tregut të lirë të punojë që në plan afatgjatë duhet të vazhdojë, pra edhe kjo është paraparë në këtë program. Sa i përket miratimit të pakos së ligjeve në reformën e administratës publike, është hapi i parë, por pastaj legjislacioni sekondar është puna më madhe që sqaron që çka nënkupton dhe klasifikon dhe do t'i kategorizojë koeficientet që veç i kemi në Ligjin për paga. Kurse, sa i përket ndërlidhjes me dokumente tjera, jemi munduar të bëjmë një ndërlidhje të mirë, jo vetëm me planin e Qeverisë dhe detyrimet që dalin nga MSA-ja, por edhe nga rekomandimet e raportit të vendit, që publikohet nga Zyra e BE-së. Rekomandimet që dalin nga rezolutat e ndryshme në Parlamentin Evropian, jemi munduar, në masë të madhe, ta bëjmë këtë koordinim. Sa i përket mospërfshirjes së autostradës në këtë program, tha se nuk bën pjesë në përfshirjen e rrjetit të autostradave evropiane dhe për këtë shkak nuk është në programin e PKZMSA-së.

Te siguria nacionale, janë disa veprime që janë të përfshira në kapitullin e demokracisë dhe sundimit të ligjit, por patjetër që edhe në këto masa nuk është se ne mund t'i diktojmë masat të cilat institucionet vetë i identifikojmë si prioritete. Ne mund t'u japim vetëm si udhëzim, por nëse ministritë përkatëse nuk i identifikojnë si prioritare, ne jemi munduar që në këtë aspekt t'i adresojmë disa nga çështjet kryesore.

Sa i përket Acquis komunitare dhe përkthimit, këtu patjetër nevojiten edhe resurse shtesë dhe kapacitete njerëzore, sepse nuk kemi zyrtarë të mjaftueshëm që duhet të merren vetëm me këtë punë. Sfidë tjetër është që zyrtarët ligjorë nuk është e nevojshme të dinë vetëm gjuhën angleze, por duhet të kenë nivel profesional të përkthimit të legjislacionit dhe në këtë aspekt jemi duke u munduar t'i shtojmë kapacitetet. Një çështje që po mundohemi ta riaktualizojmë është edhe marrëveshja që kemi nënshkruar me Republikën e Maqedonisë dhe me Republikën e Shqipërisë, për bashkëpunim, që hyn edhe përkthimi dhe njëjtë duhet ta bëjmë edhe me vendet e rajonit që t'i shkëmbejmë përkthimet. Sa i përket fondeve që u përmendën, edhe pse nuk është temë sot, keni dëgjuar për një koncept-dokument që është miratuar lidhur me IPA 3, që do ta ndërrojë tërësisht konceptin se si janë alokuar fondet deri më tani. Pra, tani IPA3 do të funksionoj në bazë të parimit të konkurrencës, pra nuk do të ketë alokime për vende

dhe kjo është vendosur në Bruksel. Kjo është një çështje për të cilën duhet të përgatitemi, sepse projektet që duhet të aplikojnë duhet të jenë të gatshme dhe të finalizuara, në kohën e aplikimit. Po sa të kemi informata ma shumë do ta kemi një takim vetëm për këtë çështje sesi do të jetë aplikimi për IPA3.

**Kryetarja** u ndërlidh në diskutim dhe tha se në shumicën e takimeve që kemi pasur me zyrtarët e BE-së, jemi kritikuar për mungesë të kapaciteteve, për të pasur projekte. A do të rrezikojë Kosova që për këtë të mos të përfitojë apo të përfitojë më pak?

**Ministrja** theksoi se për IPA 3 do të garojmë me 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, sepse do të jetë një shumë e alokuar vetëm për këto 6 shtete, mirëpo pa marrë parasysh edhe në garën me shtete shumë më të avancuara në procesin e integriteteve, në këtë aspekt, në këto dy vite që i kemi para nesh, duhet të veprimë dhe t'i ngremë kapacitetet, që të kemi edhe në aftësi absorbuese për projekte. Tani duhet të jemi më të vëmendshëm, në mënyrë që problemet që i kemi hasur në IPA1 dhe 2, kur projektet kanë filluar, por për shkak të problemeve burokratike dhe procedurave të brendshme apo mungesës së lokacionit kemi pasur vonesa dhe këtë herë kjo nuk do të jetë e tolerueshme në IPA3, sepse vonesat nuk tolerohen dhe rrezikohen fondet, prandaj duhet të gjithë të fokusohemi në këtë drejtim.

**Zenun Pajaziti**– Padyshim, ky është dokumenti ma i rëndësishëm, meqenëse edhe matja e progresit tonë varet edhe nga indikatorët e plotësimit të këtyre masave nga ana jonë, matet performanca nga vet Komisioni Evropian dhe institucionet e BE-së. Pra, është një prej agjendave kryesore, jemi të vetëdijshëm për vështirësitë dhe për sfidat. Unë do të flas në mënyrë më të përgjithshme, që mos të përsëritën, por të them diçka, si porosi edhe si kërkesë.

Ne i kemi dy detyra, si komision. E para, të fokusohemi në detyrat e Kuvendit për çka na takon si pjesë e këtij plani, pra t'i bëjmë me kohë, të cilat na kërkohen në këtë agjendë. Mendoj që këtu duhet një bashkëpunim më i mirë mes nesh, në mënyrë që mos të jemi vonë në këtë agjendë dhe pjesa tjetër që është, po ashtu e rëndësishme, e që ndoshta, nëse dimë ta shfrytëzojmë, më e rëndësishme është pjesa e zbatimit, pra e zbatimit të ligjit dhe zbatimit të këtij dokumenti, që tash është më kualitativ se tjetri, për shkak edhe të përvojës së institucioneve tuaja, si Qeveri. Në këtë drejtim, shumëçka mund të përmirësohet. Ju, si ministre, i përmendët edhe disa prej sfidave që duhet fokusuar të gjithë, por ne jemi të vetëdijshëm, që përpos adresimit të disa vështirësive, ju nuk është edhe që mundeni vetë, sepse janë një varg detyrash për të gjitha institucionet. Pra, nganjëherë, ju përpos adresimit, nuk është që mundeni t'i shtyni vetë ato. Unë kisha kërkuar, ministre, që në pjesën e zbatimit të ligjit, sidomos në pjesën e sfidave që i përmendët, t'i shfrytëzohen kapacitetet e Kuvendit, të komisionit. Siç e dini, ka qenë njëfarë gatishmërie në vitin e kaluar, kur kemi trajtuar procesin e liberalizimit të vizave, të gjithë, pa dallim, kemi qenë të kyçur për të kontribuar në këtë drejtim, por besoj siç jemi marrë vesh në një prej takimeve në komision, të merremi më shumë me MSA-në. Besoj që kjo gatishmëri do të jetë, nëse ju si ministri kërkoni një mbështetje, sepse ju e përmendët që do të bëni njëfarë monitorimi të zbatimit të masave të këtyre pikave. Nëse të paktën na dërgohen me kohë, në komision, këto raporte të monitorimit, që t'i shohim, ne kishim mundur me agjendën tonë të

fokusohe mi në disa prej sfidave, të cilat është shumë me rëndësi t'i çojmë përpara, sepse vendi ynë, në raport me proceset integruese, ka qenë i dalluar ose është edhe tash i dalluar prej vendeve fqinje edhe në raport me institucionet e BE-së. Pra, kur i kemi të adresuara këto çështje, pozitivë-opozitivë, për t'i kuptuar si një detyrë të përbashkët e të gjithëve. Pra, të kyçemi të gjithë dhe t'i shtyjmë përpara, sa më shpejt. Në fund, edhe një herë po e përsëris, matja e progresit tonë bëhet sa po e zbatojmë këtë plan.

**Visar Ymeri**– Natyrisht, shumë gjëra u thanë dhe nuk dua t'i përsëris, por mendoj që nëse i bëhet një vlerësim programit, në tërësi, konsideroj që ka një numër masash, të cilat janë shumë të hapura dhe të interpretuara, pra gjuha që është e përdorur, e lë një përshtypje që këto masa janë disi vështirë të matshme ose të paktën në këtë dokument nuk flitet për mekanizmat, si p.sh. kur përdorim termat, sikur të mirëfilltë e të vazhdueshëm e kështu me radhë, çka nënkupton kjo dhe kur përfundon kjo? P.sh. e kemi te arsimit, jo që është i vetmi problem, këtu thuhet: Duhet të vazhdohet me ngritjen e cilësisë në arsim dhe aftësimin profesional. Kjo është gjithë e vërtetë, domethënë në cilën do situatë, duhet vazhduar me ngritjen e cilësisë, pra ka të tilla masa, ka edhe konkrete në secilën fushë, mirëpo këtu mendoj që janë pak problem, sepse më duket sikur është një tendencë, do ta quaja që të plotësohet dokumenti me sasi tekste, e shpeshherë me gjëra të cilat vështirë është të diskutohen dhe vështirë është të maten. Çështja e dytë, që e kam vërejtur, është pak që kjo bie natyrisht edhe prej marrëveshjes së MSA-së, por mendoj që kjo na pret prej politikave qeveritare dhe dakordimit të tyre me BE-në, po ka një lloj animi kah sektorët e caktuar. Për shembull, nëse e lexon sektorin për politika sociale dhe punësim, aty ka shumë pak masa, pra janë 3-4 masa, të cilat natyrisht janë të mira. Do të ishte mirë të zbatohen, por nuk është se e trajtojnë një problem, i cili është një problem goxha i madh në Kosovë. Pra, në këtë drejtim, konsideroj që disa sektorë, për shembull, Infrastruktura e tjera, që janë goxha shumë të ngarkuara edhe me masa edhe me çështjet që i ngritëm dhe i diskutuam. Në anën tjetër, ka sektorë që janë të rëndësishëm nga perspektiva ime e që janë lënë nga pak si anash. Tani po kaloj prej komenteve në pyetje. I kam dy pyetje, të cilat mbase edhe nuk bien mbi fushëveprimin tënd, por meqenëse je aty, besoj që i keni diskutuar dhe do të duhej të trajtoheshin. P.sh. te energjia, thuhet që do të përmirësohet furnizimi me energji elektrike, duke i ngritur kapacitetet përmes termocentralit “Kosova e re”. Pra, kur flasim për termocentralin “Kosova e re”, flasim për një kontratë të caktuar, të nënshkruar me “Counter Global”, të cilën as Banka Botërore nuk e mbështet. A është BE në përputhje ose a e pranon një kontratë të tillë? Unë e di që ma herët janë ngritur shumë pikëpyetje, shqetësime për sa i përket çështjeve mjedisore dhe sociale, të cilat lidhen me zbatimin e kësaj kontrate. Dhe e dyta, pastaj në të njëjtë fushë, për eficientë e energjisë, domethënë a jemi duke i shfrytëzuar maksimalisht ne, si shtet, fondet të cilat ndahen nga BE për të investuar në eficientë e energjisë, sepse kjo është një çështje të cilën e diskutojmë shumë. Kemi bërë edhe amendamentimin e ligjit, të cilin është shtuar fondi për eficientë, ku ka qenë në ligjin e mëhershëm. Në këtë drejtim, pyetje ime do të ishte, deri në ç’ masë po i shfrytëzojmë fondet e BE-së, të cilat janë shumë? Pra, do të ishin shumë të mirëseardhura dhe do të ndihmonin shumë në investime në këtë fushë shumë të rëndësishme.

**Milaim Zeka**– Unë shumë shkurt do të them vetëm një sugjerim nga ana ime, që të shfrytëzoni këtë rrugë që na ka mbetur, kapacitetet e komisionit tonë. E kam potencuar vazhdimisht, askush në kontinentin e Evropës nuk ka një diasporë diamant, sikurse ne shqiptarët. Shumë djem dhe vajza tona janë jashtë me akademi. Unë vetëm nga Suedia njoh diku 20 djem dhe vajza që punojnë në administratë të Brukselit, në Bruksel, kështu që sugjerimi im është të shfrytëzojë këto kapacitete, por edhe ne si Kuvend. Përndryshe, unë gjithmonë kam qenë i kënaqur edhe jam shumë i kënaqur me lobimin tënd, me prezantimin tënd që e bën përpara botës dhe them kështu, pavarësisht se jemi armiq në politikë.

**Ismajl Kurteshi**– Ministre, më bëri përshtypje në fjalën tuaj, që numëruat masat që po ndërmerren në disa fusha. Unë do të ndalem në dy fusha. Në fushën e arsimit, ku përmendet masat që po ndërmerren edhe realisht janë ndërmarrë plotë masa, ka pasur plot konferenca, janë prodhuar shumë dokumente, ka pasur trajnime të ndryshme, mirëpo rezultatet e krejt këtyre punëve janë diku zero, sepse cilësia në arsim është ashtu siç ka qenë para 10 viteve, në disa fusha edhe më ulët, dhe tash për t'i plotësuar kriteret e MSA-së, a duhet vetëm të numërohen masat apo duhet të shihet edhe suksesi? Nëse ne vetëm numërojmë masa, por në realitet nuk kemi sukses, ato masa nuk tregohen të suksesshme, nuk e di sa i kemi plotësua ato kriteret.

Po ashtu, në fushën e sigurisë, mund të jenë marrë plot masa. Jam i sigurt që shumë njerëz që kanë shkuar edhe kanë pre pyje, pa leje, janë dënuar, por megjithatë, në fushën e sigurisë situata vetëm sa po përkeqësohet. Ju po e shihni në pikë të ditës shkojnë thyhen bankat, bëhen plot gjëra të cilat nuk flasin se siguria po rritet në këtë vend. Po ashtu, siguria për investime të huaja, vetëm sa po komplikohet, për shkak të korrupsionit të theksuar. Prandaj, është mirë të na thoni, si mendoni se ne po i përmbushim gjithë këto gjëra, duke mos pasur rezultat nga masat që po i ndërmarrim?

Çështja e tretë, që më bëri përshtypje, thatë se Ministria, Qeveria nuk ka kapacitete njerëzore për ta përkthyer legjislacionin e BE-së dhe duhet marrë njerëz të cilët i njohin ligjet e Bashkimit Evropian. Edhe kjo është një çështje që vërtet duhet diskutuar. Një Qeveri e madhe, me aq ministri e me krejt ato çka i ka, a mendoni se duhet edhe më tutje të marrë njerëz tjerë? Sepse, deri tash, janë inkuadruar njerëz, të cilët nuk kanë pasur nevojë të inkuadrohen.

**Armend Zemaj**– Ministre, te kjo ndërlidhja me Kuvendin e Kosovës, mendoj se nuk e di, ndoshta mbete borxh te raporti me Komisionin për MSA-në, por edhe specifikat tjera që janë pak më të ndejshme, sidomos te sundimi i rendit dhe ligjit dhe atë që e parafrazova në fillim, që institucionet e Kosovës kanë nevojë të jenë të pastra nga individë, të cilat kanë të kaluar të dyshimtë ose të paverifikuar. Ju e dini që edhe kërkesa që ka qenë nga BE-ja, edhe pjesa që ndërlidhet te përgjegjësitë e Kuvendit, sepse ne kemi dy komisione që e mbikëqyrin, njëri AKI-në dhe tjetri që e mbikëqyrë forcën e sigurisë. Sigurisht, që edhe individët që janë anëtarë të komisionit duhet të kenë të pastër figurën, por edhe certifikatën e sigurisë për të mbikëqyrur këto institucione. A e keni adresuar ju këtë çështje në Kuvendin e Kosovës, së paku te Kryetari i Kuvendit ose te këto komisione? Pavarësisht dallimeve që kemi, pozitë dhe

opozitë, ju e dini që është një dakordim rreth agjendës evropiane. Mendoj që duhet ta shfrytëzoni pak më shumë këtë relacion vlerësimi, por mbi të gjitha edhe implementimi të jetë më i mbikëqyrur dhe më efektiv.

**Kryetarja**– Sekretaria e komisionit, gjatë shqyrtimit të dokumentit, ka vërejtur disa prej lëshimeve që janë bërë, natyrisht që janë lëshime kryesisht teknike, por ndoshta për saktësim të disa çështjeve që ndërlihen me Kuvendin, ne kemi sugjeruar disa propozime, të cilat do t'ua dërgojmë me shkrim.

**Ministrja Dhurata Hoxha**– Faleminderit shumë për komentet dhe i mirëpresim propozimet që do t'i inkorporojmë në draftin, i cili pastaj do të përcillet në seancë plenare. Lidhur me mungesën e takimeve me Komisionin për MSA-në, patjetër që do ta iniciojmë një takim të tillë dhe është më së e rëndësishme të kemi takime edhe më të shpeshta dhe të kemi koordinime më shpesh në lidhje me MSA-në. Së pari, fillimisht mes veti dhe pastaj edhe me parlamentarët e këtij komisioni që janë në Parlamentin Evropian. Sa i përket çështjeve që u cekën këtu, po mundohem ta bëj një përmbledhje, po mund të ketë lëshime teknike, ndërsa sa i përket këtyre veprimeve të cilat domosdoshmërisht janë shumë të matshme apo janë veprime që duhet t'i zbatojnë gjithsesi. Disa nga këto veprime rrjedhin edhe nga takimet që nënkomitetet tematike i mbajnë në Bruksel apo në Prishtinë. Prapë edhe këto takime janë të përbashkëta me zyrtarët që e përcjellin çështjen e arsimit, sundimit të ligjit, dhe çështjen e ambientit. Pra, janë nën-komitete që i mbulojnë fushat e caktuara, pra fushat e ngushta dhe pastaj, gjatë këtyre takimeve, lind nevoja për adresimin e këtyre çështjeve.

Por kjo ka qenë si rrjedhojë e atyre takimeve dhe është identifikuar ndoshta si një masë e shpejtë, e cila do të siguronte se ndoshta do të duhej të fokusohemi edhe më tepër në prodhimin dhe furnizimin me energji të ripërtëritshme, sepse pa marrë parasysh që jemi ende në fillim të rrugëtimit tonë në integrimin evropian, neve do të na duhet të përmbushim kuota që veç i ka miratuar Bashkimi Evropian, brenda afateve. Sa i përket edhe shfrytëzimit të kapaciteteve të komisionit, patjetër që ndoshta nuk kemi arritur që plotësisht t'i shfrytëzojmë qoftë kapacitetet e komisionit, qoftë kapacitetet e diasporës, por edhe në këtë aspekt na nevojitet të takohemi më shpesh, por edhe në anën tjetër, gjithashtu edhe së bashku t'i identifikojmë edhe personat të cilët do të mund të na ndihmojnë në diasporë dhe ne jemi të hapur për këtë bashkëpunim edhe për takime më të shpeshta, patjetër që edhe mos të ndërhyjmë në agjendën tuaj, sepse keni edhe agjendën edhe veprime të tjera, përgjegjësi të tjera që si komision bien në fushëveprimin tuaj, por patjetër që mbesim të hapur edhe në këtë aspekt që bashkërisht të koordinohemi, për të çuar dhe për të avancuar agjendën dhe sidomos zbatimin e MSA-së, më tutje. Diçka që ndoshta do ta ndryshojmë nga viti i kaluar, është që në këtë rast, do të fillojmë kur t'i shohim shenjat shqetësuese që disa veprime po çalojnë edhe këto veprime nuk janë duke u zbatuar brenda afateve kohore, do të fillojmë të jemi edhe më të zëshëm qoftë në kritika, qoftë në adresimin e sfidave, të cilat mund të jenë sfida të natyrës të fushëveprimit të ministrisë, mirëpo nuk është përgjegjësi vetëm e një ministrie për një veprim të caktuar, por edhe e ndan përgjegjësinë me një institucion tjetër. Pra, edhe në këtë aspekt, do të mundohemi të kemi koordinim sa më të mirë.



Gjithashtu, d.m.th. energjinë, eficiencën e përmenda edhe në këtë aspekt dhe besojmë që pasi PKZMSA-ja ka afate kohore, pra kemi 10 vite që masat e caktuara duhet të zbatohen, disa nga masat unë besoj që vitet tjera do të shohim shumë më shumë masa në fushën e eficiencës dhe energjisë, energjisë së ripërtëritshme, mu për shkak se deri më tani projektet dhe absorbimi i fondeve, në këtë aspekt, ka qenë deri diku i kënaqshëm, mirëpo mendoj që ka hapësirë ende për përmirësim, sepse kemi nevojë dhe kemi projekte, të cilat me të vërtetë do të bëjnë ndryshimin. Në anën tjetër, gjithashtu po e dimë se anembanë botës është duke u investuar me të madhe në fushën e eficiencës së energjisë dhe burimit të energjisë së ripërtëritshme, mu për shkak të krijimit të vendeve të reja të punës. Pra, ka një potencial shumë të lartë të krijimit të vendeve të reja të punës. Edhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë potencial dhe të shikojmë që të hartojmë projekte që do të mund pastaj edhe të absorbonin fonde më tepër, por në anën tjetër, ta zbutim pa punësinë në Republikën e Kosovës. Sa i përket a numërohen vetëm masat apo zbatimi i tyre dhe efekti, mundohemi që t'i bëjmë të dyja. Do të thotë që masat këtu identifikohen në PKZMSA. Po e përsëris prapë, se jemi munduar të kemi masa më cilësore në vend sesa masa kuantitative dhe me të vërtetë kur të zbatohen këto masa të fillojmë t'i shohim edhe ndryshimet, sepse nuk bëjnë të kalojnë vite nga zbatimi i PKZMSA-së dhe ne nuk kemi hyrë as në substancën kryesore apo në esencën thelbësore të MSA-së. Reformat dhe përfitimet që kjo sjellë, pra nuk duhet të zbatojmë veprime periferike, ndërsa mos të fokusohemi në substancën kryesore. Ky ka qenë edhe qëllimi i këtij programi, që të kemi veprime që janë konkrete. Ndërsa, sa i përket sigurisë, në përgjithësi, ne këtu kemi paraparë masa dhe gjithashtu edhe kemi bërë kërkesa më herët dhe këto kërkesa janë të vazhdueshme që të kemi një mekanizëm të qëndrueshëm, një mekanizëm të sigurt. Pra, edhe mekanizmi i vetingut, pra ta quajë ashtu, apo i verifikimit të kaluarës, verifikimit dhe lëshimit të situatave të sigurisë dhe klasifikimit të nivelit të sigurisë, sistemi duhet të jetë fillimisht i mirë dhe i sigurt, në mënyrë që kur të lëshohet një certifikatë e tillë, me të vërtetë të dihet se është lëshuar dhe i takon nivelit sensitiv, nivelit pjesërisht të klasifikuar apo nivelit të klasifikuar. Pra, në këtë aspekt, patjetër që duhet të ndërmarrim hapa konkretë, që ta bëjmë lidhjen e tërë kësaj hallke. Besoj që është shumë me rëndësi që jo vetëm anëtarët e komisionit, pra të mbikëqyrjes së AKI-së apo "FSK"-së, të kenë certifikata të tilla, por edhe personat që punojnë në institucione kyçe dhe kanë apo përdorin dhe pranojnë informata sensitive apo të klasifikuara, që të parandalojmë rrjedhjen e këtyre informatave në publik. Pra, është një fushë që patjetër duhet ta rregullojmë, nuk hyn MSA-ja në detaje. Në këtë aspekt, besoj që me mekanizmat tjerë duhet ta adresojmë. Unë besoj që pak a shumë i përmbylla të gjitha, pra patjetër që të gjitha sugjerimet e juaja dhe këshillat do t'i kemi parasysh dhe do të mundohemi që me të vërtetë të kemi një koordinim edhe më të mirë, edhe takime më të shpeshta, me komisionin dhe anëtarët e komisionit, sepse siç e thatë edhe ju, PKZMSA-ja, gjegjësisht MSA-ja, nuk është vetëm një marrëveshje e Ministrisë së Integritimit Evropian, por është një marrëveshje e shtetit, pra nuk është as e Kuvendit, as e Qeverisë, por janë të gjitha institucionet, duke përfshirë këtu edhe shoqërinë civile, mediat, sektorin privat dhe të gjithë këta sektorë apo segmente të shoqërisë tonë adresohen në MSA dhe përmbajnë reforma të thella, të cilat duhet t'i

zbatohet. Unë ju falënderoj shumë dhe presim komentet e juaja në të shkruar dhe t'i inkorporojmë në draftin final që pastaj prapë do të përcillet në seancë plenare.

**Kryetarja** falënderoi ministren dhe tha se shumë shpejt do të kenë takim në fazat tjera të mbikëqyrjes së zbatimit, ndoshta në tremujorin e parë ose në takimet tjera, sepse së shpejti do të jetë edhe raporti për vendin dhe do të kemi rast të bisedojmë. Pra, po flas në emër të komisionit, që deputetët janë të gjithë të gatshëm që të bashkëpunojmë dhe të koordinohemi më mirë, sidomos për faktin që kemi masa më të shtuara, sa i përket Kuvendit.

Na pret punë më e madhe në këtë fazë, si Kuvend, duhet të jemi shumë të afërt për bashkëpunim, mirëpo Qeveria i ka mekanizmat më të fuqishëm se ne deputetët dhe këtu presim që edhe ju të jeni më e hapur, që të na ftoni dhe të jemi prezentë.

Ne vazhdim, e hodhi ne votim Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, dhe pas votimit, konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Miratohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2019-2023.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja** paraqiti opinionin ligjor për këtë projektligj dhe tha se çështjet e rregulluara dhe të adresuara me këtë projektligj nuk janë në kundërshtim me legjislacionin të Bashkimit Evropian dhe mund të rekomandohet për miratim në seancë plenare. Hap debatin, nëse ka diskutime. Nëse jo, atëherë ftoj deputetët, që të deklarohen me votë për projektligjin.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-101 për të drejtën ndërkombëtare private, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryetarja**, lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinionin ligjor dhe theksoi se çështjet që rregullohen dhe adresohen me këtë projektligj nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe mund të rekomandohen për miratim në Kuvend.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

**Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-101 për të drejtën ndërkombëtare private, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e komisionit.**

**Kryetare e komisionit,**

**Blerta Deliu-Kodra**

-----